



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislacioni IV

Sesioni pranveror

Komisioni për Punë të Jashtme

Mbledhja nr. 61

Prishtinë, më 26 korrik 2013, në orën 14:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S-2

P r o c e s v e r b a l

I mbledhjes së Komisionit për Punë të Jashtme

Në mbledhje morën pjesë: Albin Kurti, Hydajet Hyseni, Enis Kervan, Donika Kadaj-Bujupi, Emilija Rexhepi, Hamza Balje.

Munguan: Berat Buzhala, Skënder Hyseni, Sabri Hamiti.

I pranishëm në mbledhje, ishte ministri i Ministrisë së Punëve të Jashtme, z. Enver Hoxhaj, me ftesë të Komisionit dhe stafi nga MPJ: Ylber Kryeziu, Sylë Ukshini, Albinot Bimbashi, Gëzim Visoka, Muhamet Brajshori e Artan Behrami.

Pjesëmarrës të tjerë: Vlora Nushi- UNMIK/OPA, Besnik Ramadani –KDI dhe mediat.

Nga Zyra e Komisionit: Minire Hasani, Manush Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi, Albin Kurti, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

R e n d d i t e:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura më 19 dhe 26 qershor 2013;
3. Raportim i ministrit të Ministrisë së Punëve të Jashtme, z. Enver Hoxhaj;
4. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari konstatoi se Komisioni e miratoi rendin e ditës.

2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura më 19 dhe 26 qershor 2013

Kryetari konstatoi se, Komisioni i miratoi njëzëri procesverbalet nga mbledhjet e mbajtura më 19 dhe 26 qershor 2013.

3. Raportim i ministrit të Ministrisë së Punëve të Jashtme, z. Enver Hoxhaj

Albin Kurti, falënderoi Ministrin Hoxhaj që i është përgjigjur ftesës së Komisionit, për të raportuar në Komision.

Enver Hoxhaj, shprehu kënaqësinë që në këtë takim, të njoftojë anëtarët e Komisionit për të gjitha zhvillimet kyçe në politikën e jashtme gjatë muajve të fundit. Ndër prioritetet kryesore të MPJ-së, tha se ka qenë fuqizimi i pozitës ndërkombëtare të Kosovës. Në këtë drejtim njoftoi se kanë qenë të detyruar të ndjekin rrugën e njohjeve individuale, pasi që njohjet kolektive ndërkombëtare nuk kanë ndodhur pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës. Informoi anëtarët e Komisionit se gjatë këtij viti ka vizituar 30 shtete, të cilat nuk e kanë njohur pavarësinë e Kosovës, disa nga të cilat tha se janë bërë publike e disa nga ato vizita nuk janë bërë publike. Theksoi se gjatë kësaj periudhe ka pasur një valë të njohjeve të Republikës së Kosovës. Gjatë muajit qershor kanë arritur pesë njohje dhe priten së shpejti edhe tri njohje, të cilat dëshmojnë se procesi i njohjes së Kosovës është i pandalshëm. Bëri të ditur se MPJ ka prioritet edhe bashkëpunimin institucional me pesë vendet e BE-së, që nuk e kanë njohur Kosovën, me qëllim të lëvizjes së tyre rreth njohjes së Kosovës.

Ai tha se prioritet i dytë i MPJ-së ka qenë anëtarësimi i Kosovës në organizata rajonale, evropiane dhe ndërkombëtare, me ç'rast theksoi anëtarësimin në Bankën Zhvillimore të Këshillit të Evropës dhe në Këshillin Rajonal për Bashkëpunim, me qendër në Sarajevë. Ministri Hoxhaj, po ashtu, njoftoi se si rezultat i dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë, nga lista prej 26 organizatave të cilat u ofruan kur u arrit marrëveshja, është arritur anëtarësimi në 16 prej tyre. Theksoi interesimin e MPJ-së për anëtarësimin e Kosovës në Këshillin e Evropës, për të cilin tha se është një proces i cili merr kohë, e i cili edhe vendeve të rajonit iu ka marrë dy – tre vite për anëtarësim. Po ashtu, bëri të ditur se janë në rrugë e sipër të një studimi, i cili do të duhej të shpjegonte qëllimin, mënyrën, rrugën dhe strategjinë e ofrimit të Kosovës në OKB, dhe se në momentin e përgatitjes së këtij materiali, janë të gatshëm që ta ndajnë me anëtarët e Komisionit. Prioritet tjetër të MPJ-së, theksoi agjendën e integritetit evropian të Kosovës dhe rëndësinë e hapjes së negociatave për MSA-në. Po ashtu, ministri bëri të ditur se prioritet tjetër i rëndësishëm i MPJ-së është agjenda euroatlantike e Kosovës, me ç'rast njoftoi se në të gjitha vizitat e tij, përveç agjendës evropiane, ka pasur edhe agjendën e integritetit në NATO. Ministri Hoxhaj njoftoi se MPJ, gjendet në fazën e rishikimit të dy ligjeve bazike, si dhe është duke hartuar një dokument për parimet kryesore të politikës së jashtme.

Albin Kurti, gjatë diskutimit të tij e pyeti Ministrin Hoxhaj se, pse nuk po i përgjigjet ftesave të Komisionit, nga fakti se gjatë vitit 2012 ishte vetëm një herë për të raportuar në Komision. Gjatë këtij viti, tha se ministri ka raportuar një herë dhe kjo është hera e dytë, duke shtuar se ky takim është dashur të ndodhte para se të ratifikohet në Kuvend, Marrëveshja për normalizimin e marrëdhënieve në mes të Kosovës dhe Serbisë. Ratifikimin e Marrëveshjes e cilësoi me mangësi procedurale e demokratike, për faktin se nuk është diskutuar paraprakisht në Komision, së bashku me ministrin dhe kryeministrin. Duke u ndërlidhur me raportimin e zëvendëskryeministrit, z. Behgjet Pacolli në Komision, pyeti ministrin Hoxhaj lidhur me njohjet nga Nigeria, Mali e Uganda, si dhe për numrin e përgjithshëm të njohjeve të Kosovës. Lidhur me materialet të cilat u janë sjellë anëtarëve të Komisionit nga MPJ, pyeti: Pse në Marrëveshjen për siguri shoqërore me Austrinë është caktuar afati shumë i shkurtër i njoftimit për shkëputje të marrëveshjes dhe si ka qenë komunikimi lidhur me të? Sa i përket punimit “Non-Paper”, pyeti: Sa ka kushtuar, cilat janë mësimet e nxjerra dhe cilat do të jenë strategjitë e mekanizmat për të ecur më tutje në përputhje me këtë punim?

Duke cekur deklaratat e ministrit Enver Hoxhaj, të ministres Vlora Çitaku dhe mediave, lidhur me azilkërkuesit, z. Kurti pyeti: Cila është e vërteta për ta, çfarë ka bërë konkretisht ambasada jonë në Hungari për shtetasit tanë që janë atje, pse nuk ka pasur një vizitë të institucioneve tona në mënyrë të organizuar në ato kampe, që të kuptojmë drejtpërsëdrejti gjendjen? Lidhur me njohjet, pyeti ministrin: A janë realizuar pritjet për njohjet, a na ka njohur El Salvadori, a janë marrë notat verbale për njohjet nga shteti i Tanzanisë, Jemenit, Egjiptit e Guajanës?

Ai, po ashtu, pyeti se a është emëruar z. Ramadan Avdiu, ambasador i Kosovës në Bernë të Zvicrës dhe se a mund t'i sillet Komisionit, brenda dy javëve, një listë e përditësuar për secilën ambasadë të Kosovës dhe për secilën pozitë ekzistuese nëpër këto ambasada?

Duke u ndërlidhur me dëgjimin e z. Lulzim Peci në Komision, z. Kurti pyeti: Çfarë statusi juridik dhe diplomatik ka prezenca e Republikës së Kosovës në Beograd? A është në nivel të misionit diplomatik, nëse po, a ka pasur shkëmbim të letrave kredenciale në mes të dy shteteve për themelimin e marrëdhënieve diplomatike? Nëse jo, pse Qeveria i referohet zyrtarit tonë ndërlidhës si ambasador? Cilat janë limitet e autorizimit të zyrtarit tonë në Beograd, a është i autorizuar ai për të vendosur komunikim me institucionet e Serbisë që nuk e pranojnë statusin e pavarur të Republikës së Kosovës? Cilat ishin lëshimet e z. Lulzim Pecit si ambasador në Suedi, kur i keni kuptuar ato, për sa lëshime bëhet fjalë? Pse pas këtyre lëshimeve iu besua detyra e ambasadorit jo-rezident në Islandë e Lituani? Në vazhdim, z. Kurti pyeti edhe lidhur me komunikatën për takimet e paautorizuara të z. Peci me përfaqësues të shtetit të Serbisë, për bazën juridike për propozim-shkarkimin dhe procedurat për shkarkimin e tij, si është dërguar z. Peci në Beograd, kur e dinit se do të shkarkohej, sepse të gjitha ndërrimet që janë bërë tek ambasadorët kanë qenë në emër të forcimit të shërbimit të jashtëm dhe të ndërtimit të diplomatëve të karrierës. Në vijim, z. Kurti parashtrroi edhe këto pyetje: A ka MPJ sistem të integruar të menaxhimit të qëndrimeve në politikën e jashtme? A i është dhënë ambasadorit Lulzim Peci një listë fundamentale e qëndrimeve që duhet mbajtur në Beograd? Pse ka qenë problematike deklarata e z. Pecit, e cila nuk i ka pëlqyer Kryeministrit Thaçi, që normalizimi i raporteve ndërmjet Republikës së Kosovës dhe asaj të Serbisë do të ndodhë vetëm atëherë kur kjo e fundit e njeh pavarësinë e Kosovës? Pse ka qenë problematike adresimi i z. Pecit në konferencë për media në gjuhën e vendit ku ka shkuar dhe jo të vendit që përfaqëson?

Hydajet Hyseni, në fjalën e tij, përshëndeti ministrin dhe stafin e tij për punën impulsive që bëhet në MPJ, duke pasur parasysh se është një resor i ri në konsolidim e sipër. Ai shtoi se angazhimi ynë është nga motivi e synimi për të pasur një qasje përplotësuese komplementare të kësaj fushe që është interes i pakontestueshëm i të gjithëve dhe një fushë që do të duhej të na bashkonte më shumë se çdo fushë tjetër. Z. Hyseni pyeti: Sa është arritur që të ndërtohen mekanizma të koordinimit, harmonizimit, dhe bashkërendimit të përpjekjeve midis institucioneve? Cili është niveli që kemi arritur dhe cilat janë sugjerimet e Ministrisë? Cila është shkalla e angazhimit dhe koncepti që ka shërbimi ynë diplomatik në raport me të gjitha institucionet? Po ashtu, shtroi çështjen se relacionet midis Kosovës, komunikimi e dialogu që bëhen me Serbinë, a trajtohen si çështje të jashtme dhe a varen nga shkalla e angazhimit të MPJ-së, dhe po qe se një çështje ekuivalente me një vend tjetër fqinjë ka trajtim tjetër, kritere të tjera, procedurë tjetër, ku çon si precedentë? Duke u ndërlidhur me rolin e Komisionit në procesin e mbikëqyrjes së zbatimit të ligjeve, shtroi çështjen se cilat marrëveshje ndërkombëtare konsiderohen të ratifikuara vetëm nga Presidentja dhe cilat dërgohen në Kuvend për ratifikim. Këtë çështje e konsideroi të kontestueshme dhe pyeti nëse MPJ-ja ka formuar një bazë juridike se në bazë të cilave kritere një marrëveshje procedohet për ratifikim. Për nevojat në rritje të shërbimit diplomatik, pyeti nëse mjafton buxheti i ndarë i MPJ-së, që në vitet pasuese, një angazhim i përbashkët me Komisionin lidhur me buxhetin, do të ishte i dobishëm dhe në

funksion të avancimit të shërbimit diplomatik. Z. Hyseni, lidhur me nismën për përfaqësim të përbashkët, kërkoi të informohet se çka është bërë dhe ku është arritur në këtë drejtim.

Enis Kervan, lidhur me raportimin e ministrit Hoxhaj, tha se do t'i parashtrojë disa pyetje dhe disa komente. Sipas njoftimit të ministrit, z. Kervan pyeti: Sa do të ndikojnë këto takime të cilat i ka pasur, e sidomos ajo në Vatikan, në fuqizimin e politikës ndërkombëtare të Kosovës? Sa u përket 11 organizatave që na kanë mbetur për t'u anëtarësuar, pyeti: A mendoni që ka përparësi ndonjë organizatë më tepër që të anëtarësohemi dhe a ka ndikim prej shteteve mike në këtë drejtim? Ku gjendet Kosova rreth anëtarësimit në Këshillin e Evropës? A kemi bashkëpunim konkret me shtetet mike të Kosovës, lidhur me zhvillimin e procesit dhe krijimit të kushteve për anëtarësim në NATO? Duke u ndërlidhur me dëgjimin e z. Pecit në Komision, theksoi se me rastin e rishqyrtimit të ligjeve, kishte qenë mirë që të krijohet mundësia që ambasadorët të informojnë Komisionin për punën e tyre, dhe të mos ndodh sikur me rastin e z. Peci, të informojë Komisionin pas dorëheqjes. Sa i përket udhëtimeve zyrtare, kërkoi nga ministri që në delegacionin e tij të ketë edhe përfaqësues nga KPJ të komunitetit shumicë, por edhe nga komuniteti jo shumicë, ngase edhe ata mendojnë se e ardhmja e Kosovës është në BE. Përfaqësimin e Kosovës në Beograd e sheh si një hap të rëndësishëm, qoftë në cilësi të zyrtarit ndërlidhës, qoftë të ambasadorit. Shtroi pyetjen: A është arritur ndonjë marrëveshje konkrete me shtetet që na kanë njohur, lidhur me njohjen e pasaportave diplomatike?

Donika Kadaj Bujupi, në mes tjerash theksoi se raportimi i ministrit kryesisht ishte i përqendruar në prioritetet e MPJ-së, brendapërbrenda ministrisë dhe në çështjet e lobimit për njohje, por Kosovës i nevojiten investimet e huaja. Për këtë çështje tha se nga zëvendëskryeministri, z. Behgjet Pacolli, nuk morëm të dhëna të sakta për përpjekjet e sjelljes së investimeve të huaja në vend. Në këtë drejtim, shtroi pyetjen: A ka ndonjë plan konkret, a po përkrahet ai edhe nga Kryeministri dhe dikasteret e tjerë që të ndryshohet kjo gjendje dhe se a do të shohim investime të mëdha në Kosovë në një periudhë të ardhshme?

Emilija Rexhepi, në diskutimin e saj kërkoi nga ministri të informohet për kontaktet me Bosnjën dhe shprehu gatishmëri që të ndihmojë në këtë drejtim, duke pasur parasysh se ai vend ende nuk e ka njohur pavarësinë e Kosovës. Po ashtu, u interesua të njoftohet se cili është numri i të punësuarve në misione diplomatike nga komunitetet pakicë, përkatësisht nga komuniteti boshnjak, si dhe u interesua për çështjen e liberalizimit të vizave dhe për çështjen e nënshkrimit të MSA-së.

Enver Hoxhaj, duke u përgjigjur në pyetjet e deputetëve, njoftoi për mënyrat e ndryshme të procedurave të shteteve të ndryshme për njohjen e Kosovës. Marrëveshja me shtetin e Austrisë për siguri shoqërore, theksoi se është çështje reciprociteti në mes të dy vendeve dhe se janë duke punuar në këtë drejtim. Lidhur me çështjen e azilkërkuesve, ministri tha se e ka ndjekur në mënyrë intensive, për 480 persona të cilët gjenden në Hungari, janë të interesuar të gjejnë një zgjidhje me autoritetet hungareze që këta azilkërkues të kthehen në Kosovë. Njoftoi se azilkërkuesve u ka qëndruar afër ambasada jonë dhe se ata nuk kanë qenë të keqtrajtuar. Sa i përket hartimit të dokumentit "Non Paper", bëri të ditur se për hartimin e dy dokumenteve të tilla të fundit, eksperti është paguar në shumë prej 400 eurosh. Lidhur me deklaratën e dhënë më 27 shkurt 2013, se së shpejti do të kemi gjashtë deri në shtatë njohje të reja të Kosovës, theksoi se jemi dëshmitarë të pesë njohjeve të reja. Ministri njoftoi se nga shteti i El Salvadorit ka arritur nota verbale për njohjen e Kosovës. Ai tha se listën e plotë me stafin e ambasadave do t'ia përcjellë Komisionit, por se nuk mund të sigurojë se do të mund të jetë statike, sepse gjenden në fazën e rotacionit. Po ashtu, tha se jemi të angazhuar që njerëzit me përgatitje profesionale, me njohuri të gjuhëve të ndryshme dhe përvoja të ndryshme të jetës, t'i ofrojmë në sistem. Lidhur me ish- ambasadorin Peci, tha se për disa

takime të z. Pecit që ka marrë pjesë në Bruksel ka pasur vërejtje, sepse shpeshherë ka bërë përpjekje që të lëvizë përtej mandatit që i është dhënë. Theksoi se z. Peci nuk është larguar nga detyra për shkak të dallimeve në çështje politike, ndërsa sa i përket vlerësimin të ambasadorëve, tha se ka vlerësime të ambasadorëve dhe se është i interesuar që ambasadorët më të mirë të lëvizin në vendet më të mira. Lidhur me qëndrimet për politikën e jashtme, tha se kemi koordinim të plotë me Presidenten, Kryeministrin dhe bartës të tjerë të institucioneve.

Po ashtu, ai bëri të ditur se çdo ambasador i cilitdo shtet, para se të bëjë një intervistë në një medium, merr leje nga ministria e tij dhe nuk mund të dalë përtej mandatit që ka, përtej një qeverie të caktuar. Sa i përket koordinimit në politikë të jashtme, theksoi se ekziston koordinimi në mes të mekanizmave të politikës së jashtme, Presidentes, Kryeministrit dhe se bën informata në baza javore me ata. Po ashtu, komunikon edhe me ministrinë e linjës, varësisht nga çështja. Për relacionet me vendet përreth, konkretisht me Serbinë, tha se prej dt. 4 mars deri më 19 prill, kur është arritur Marrëveshja për normalizim të marrëdhënieve në mes të Kosovës dhe Serbisë, MPJ ka qenë pjesë e dialogut nga aspekti i politikës së jashtme, ndërsa për bisedimet për energjinë dhe telekomunikacionin, nuk kanë pasur kapacitete dhe njohuri të tilla. Sa i përket mbikëqyrjes së Ligjit për marrëveshje ndërkombëtare, bëri të ditur se nënshkrimi i marrëveshjeve ndërkombëtare është një ndër objektivat e MPJ-së dhe njoftoi për procedurat e arritjes së tyre. Lidhur me buxhetin e MPJ-së, tha se këtë vit ka qenë i rritur për shkak të hapjes së misioneve të reja dhe se nuk kanë vështirësi financiare në MPJ. Njoftoi se Kosova me Shqipërinë ka shërbime të përbashkëta konsullore dhe se janë të interesuar që të nënshkruajnë marrëveshje të njëjta edhe me vendet tjera të rajonit. Ministri, duke u ndërlidhur me pyetjet e deputetit Enis Kervan, njoftoi se Greqia, Rumania dhe Sllovakia kanë qëndrim të hapur dhe janë fleksibil ndaj Kosovës dhe se do të lëvizin në këtë drejtim. Njoftoi se Spanja e Qipro i kanë arsyet e brendshme karshi Kosovës, por këto vende nuk e kanë bllokuar MSA-në dhe se në MPJ janë duke punuar që këto vende të mos e bllokojnë të ardhmen e anëtarësimit të Kosovës në NATO. Lidhur me vizitën në Vatikan, për të cilën tha se ka qenë zyrtare dhe jopublike, njoftoi se Vatikani ka ambicie që të jetë i hapur për të vendosur marrëdhënie diplomatike me shumë shtete, me të cilat nuk ka pasur marrëdhënie diplomatike. Ministri njoftoi për situatën dhe angazhimin e MPJ-së për anëtarësim të Kosovës në Këshillin e Evropës, në NATO dhe në organizata të tjera. Sa i përket rishikimit të ligjeve, shprehu gatishmërinë që KPJ të jetë i integruar, dhe posa të përgatitet drafti i parë, t'i përcillet anëtarëve të Komisionit. Ministri njoftoi se investimet e huaja dhe diplomacinë parlamentare i kanë prioritet në MPJ dhe se në këtë drejtim janë mbajtur 11 forume të përbashkëta, në vende të ndryshme dhe se janë të interesuar të kenë sa më shumë investitorë. Bëri të ditur se Këshilli i Evropës ka vendosur për qasje të Kosovës në rreth 27 programe kyçe në të gjitha fushat e jetës që kanë të bëjnë me mbështetje financiare. Anëtarësimi i Kosovës në Bankën zhvillimore të Këshillit të Evropës dhe në Këshillin rajonal për bashkëpunim ka të bëjë me mbështetje konkrete financiare në projekte. Në pyetjen e deputetes Emilija Rexhepi, lidhur me kontaktet me Bosnje e Hercegovinën, ministri theksoi se kanë kontakte direkte dhe se do të jenë në dispozicion, nëse do të ndërmerret ndonjë vizitë në Bosnjë.

Më tutje, ai tha se Bosnja është një nga vendet në rajon që nuk ka politikë të jashtme dhe shpeshherë vendimet për interesa strategjike të politikës së jashtme të Bosnjës merren në Beograd. Nga komuniteti pakicë njoftoi se në misione janë të kyçur pesë pjesëtarë të komuniteteve pakicë.

Ministri theksoi se, z. Peci me dorëheqjen e tij e ka dëmtuar imazhin e Kosovës dhe se nuk ka qenë problem përdorimi i gjuhës serbe nga z. Peci në Beograd, por komunikimi i tij ka qenë me një serbishte të pakultivuar dhe pa nivel. Misioni i Republikës së Kosovës në Serbi është i definuar si mision i posaçëm i Kosovës në Serbi, me pajtim të Serbisë. Lidhur me z. Ramadan Avdiun, tha se ai i ka kaluar procedurat për titullin e ambasadorit, sepse ky titull ka qenë i nevojshëm, për shkak të

pozitës ndërkombëtare që ka Kosova. Njoftoi se Kosova ka notën verbale për njohje nga Tanzania, nga Jemeni, me Guajanën është nënshkruar marrëdhënia diplomatike, El Salvadori e ka njohur Kosovën, nga Egjipti ka arritur vendimi për njohje në MPJ. Mali tha se asnjëherë nuk e ka njohur Kosovën, ndërsa për Nigerin dhe Ugandën, tha se gjenden në procedurë të verifikimit të njohjes së Kosovës.

Hydajet Hyseni, ndër të tjera njoftoi për anashkalimin e KPJ-së për shqyrtimin e marrëveshjeve dhe theksoi se duhet insistuar që çështjet e jashtme të Kosovës, të trajtohen si çështje të jashtme, ato të brendshme të trajtohen si çështje të brendshme, ndërsa në rastet e nevojshme në mes të shteteve, të merret parasysh parimi i reciprocitetit, i cili tek ne nuk po funksionon.

Albin Kurti, ngriti çështjen e anashkalimit të Komisionit, për mosdorëzimin e materialit sa i përket Marrëveshjes së parë të normalizimit të marrëdhënieve midis Republikës së Kosovës dhe Serbisë, për të cilën tha se prej titullit deri te nënshkrimi, nuk trajtohet njësoj prej palëve. Për çështjet e tjera, të cilat u ngritën në Komision, nuk u arrit të merret përgjigje. Ai tha se ministri mund të na përgjigjet me shkrim. Po ashtu, tha se do t'ia përcjellë ministrit disa pyetje për përgjigje, lidhur me materialin të cilin e solli për anëtarët e Komisionit.

Takimi përfundoi në orën 16:30.

Kryetari i Komisionit

Albin Kurti

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.